

## Pikat mbështetëse me rastin e riatdhesimit vullnetar

**Ju që hamendeni ose veç keni vendosur që të ktheheni në atdhe, me siguri keni shumë gjëra të cilat dëshironi t'i keni të qarta. Duke vënë në pah gjëra të cilat duhet t'i keni parasysh, Enti për Migrim do që t'u ndihmojë që vendimi juaj të jetë mirë i menduar. Lista me siguri që do të mund të kompletohej edhe me shumë pika tjera prandaj ne dhe kemi lënë vend për shënime tuaja personale.**

### Të mendosh në lidhje me... ... shëndetin

- Si funksionon shërbimi shëndetësor në shtetin ku shpërngulesh.
- Barnat që janë të domosdoshme dhe nëse gjenden për t'u blerë atje.
- Mjete ndihmëse që të nevojiten dhe nëse gjenden atje për furnizim.
- Vaksinimet që duhet t'i marrësh para se të udhëtosh.
- Shënimet mjekësore që ke nevojë t'i marrësh me vete (eventualisht të përkthyer).
- .....
- .....

### ... punën

- Vend praktikimi në një ndërmarrje të Suedisë ku mund të përgatitesh e të marrësh njohuri mbi veprimtarinë që dëshiron ta ush trosh në atë shtet ku do të shpërngulesh, (mund të kërkohet përmes Zyrës së punësimit).
- Projekt riatdhesimi në Suedi që mund të të japë mundësi më të mira në vend.
- Dëftesa notash, vërtetime dhe karakteristika vlerësuese mund të kenë rëndësi për mundësitë

e punësimit në të ardhmen (eventualisht të përkthyer).

- Kontakte që mund të jenë të çmueshme për t'i ruajtur në Suedi, p.sh. puna dhe shkolla.
- Dëftesë punësimi nga punëdhënësi yt i ri në shtetin në të cilin shpërngulesh.
- .....
- .....

### ... shkollën

- Kontakto autoritetet ose administratën përkatëse në shtetin në të cilin shpërngulesh, për informacion në lidhje me arsimimet e ndryshme shkollore.
- Komplettoi ato dëftesa që nevojiten për studime të mëtutjeshme në shtetin në të cilin shpërngulesh.
- Të të pranohen arsimimet dhe shkollimet e ngjajshme në Suedi.
- Përkthei vërtetimet dhe dëftesat e notave nga shkollat dhe kurset suedeze.
- .....
- .....

### ... sigurinë

- Ligjet në fuqi që të prekin ty (nëse dëshiron mund të marrësh kontakt me përfaqësinë më të afërt diplomatike të shtetit).
- Të drejtat dhe detyrimet në shtetin ku do të kthehesh.
- Rreziqet në zonat e mëparshme luftarake, p.sh. mina dhe granata.
- Konflikte etnike që ende ekzistojnë.

.....

### ... banesën në Suedi

- Njohtohu mbi kohën e lajmërimit të lënies së banesës dhe lajmëro daljen nga banesa para shpërnguljes.
- Lajmëro shpërnguljen te zyra lokale tatimore, porosite formularin "flyttning till utlandet" (shpërngulje jashtë shtetit).
- Ndërroje adresën në postë.
- Lajmëro mbylljen e telefonit, ndaljen e gazetave etj.
- .....

### ... banesën në shtetin ku shpërngulesh

- Situata e tregut banesor.
- Dëshmi pronësie për banesën në të cilën shpërngulesh dhe nëse ke nevojë për ndihmë juridike.
- Reparime të banesës apo shtëpisë.
- Jepja adresën e banesës së re personave që janë të rëndësishëm për ty.
- .....

### ... ekonominë në Suedi

- Rregullat e Arkës së sigurimit mbi kursimin e pensionit, ndihmën gjatë sëmundjes, shtesat fëmimore etj. me rastin e riatdhesimit, dhe se çfarë ndodh nëse nuk je shtetas i Suedisë.
- Merr kontakt me CSN (Këshilli qendror studimor) nëse ke marrë hua për pajisje banesore ose për studime.
- Paguaje huanë/borxhin ose bëj një marrëveshje mbi pagimin, para se të udhëtosh.
- Kërko ndihmë nga komuna ku jeton.
- Kërko ndihmë për udhëtimin në shtëpi nga Enti i Migracionit - Migrationsverket, telefoni 0771-235 235.
- .....

### ... ekonominë në shtetin ku shpërngulesh

- Si funksionon sistemi i sigurimit social me ujdi, pensione, ndihma etj.
- Si funksionon sistemi arsimor, nëse për shembull, është falas, nëse ka ndihma studimore apo mundësi për të marrë bursë.
- Subvencione, p sh, për banim, për nismë të ndërmarrjes private ose firmave kooperuese.
- Organizata vullnetare në vend që mund të ofrojnë ndihmë.
- .....

### ... udhëtimin

- Planifikoje udhëtimin dhe transportimin e mobiljeve në kohën e duhur para nisjes.
- Rregulloi sigurimet që janë të domosdoshme për udhëtimin dhe transportimin.
- Rregulloi ato dokumente që do të duhet t'i marrësh me vete, pos tjerash, certifikata personale, letërnjoftimi-ID, patenta e shoferit, lista e meritave personale (CV), deklarimet e fundit tatimore, dokumente doganore.
- .....

Trego hapur brenda familjes mbi planet e kthimit dhe mbi pritjet e shpresat që ka secili. Posaçërisht e rëndësishme është të flasësh me fëmijët. Ata ndoshta janë rritur në Suedi dhe mund t'u nevojitet ndihma jote për të kuptuar. Poashtu është me rëndësi që në lidhje me shpërnguljen ta përgatisësh familjen tënde dhe të afërmit e tjerë në shtetin ku do të shpërngulesh Kontaktet para nisjes kanë rëndësi për planifikimin. Diskuto edhe mbi atë se çfarë janë pasojat nëse vendimi për kthim nuk realizohet, ose nëse çdo gjë nuk rrjedh siç e ke menduar.

*Këtë informatë e ka hartuar Enti i Migracionit (Migrationsverket), së bashku me Kryqin e kuq të Suedisë (Svenska Röda Korset), Misionin social (Sociala Missionen), Caritas Suedi (Caritas Sverige), Zyrën e riatdhesimit të qytetit të Stockholm-it (Stockholms Stads återvandringskontor) dhe Lidhjen komunale suedeze (Svenska Kommunförbundet).*